



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data: 04.06.2024

NR: 04-353-zyrtar

**Procesverbali nga mbajtja e Shqyrtimi Publik me qytetarë për Projekt-Planit
Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit**

Shqyrtimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e shqyrtimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **24.05.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftimi-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Planit-Rregullues-i-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-1.pdf>

Në facebook:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02iGibBgEMtt9Afs2k3A89MGWTHZywhiJ4qfs3RZKmkSbPxo2UKhcYKxEgxdM5j1Lol&id=100064489910139&mibextid=RtaFA8

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php?OpenPage=30&ClosedPage=0>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftimi-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Planit-Rregullues-i-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-1.pdf>

Shqyrtimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:15

Hapjen e shqyrtimi është bërë nga Drejtori i Urbanizmit, Planifikimit Hapësinorë (DUPMH), **Pranverim Berisha** i cili ka thënë se këtë dokument e kemi hartuar me njohësit e kësaj fushe e drejtorisë dhe ekspertet e angazhuar si konsulent, me këtë dokumento do të u lehtësohet puna bizneseve të komunë, realisht ky është edhe qëllimi i këtij dokumenti.

Ne jemi këtu që ti marrim edhe komentet, sugjerimet apo edhe vërejtjet eventuale që ju i keni për dokumentin dhe ato më pastaj të hynë në dokumentin final para se dokumenti të miratohet në kuvend nga anëtarët e kuvendit.

Shpresa Osmanollaj, zyrtare në DUPMH, takime me biznese dhe me qytetarë kemi pasur në vazhdimësi dhe nga ato takime kemi marrë të dhëna e që më pas ato të dhëna janë futur në dokumentin final nga zyrtarët përgjegjës, mendoj që ky dokument është shumë i mirë për bizneset e komunës. Te gjithë të interesuarit kanë kohë prej 30 ditësh që kërkesat e me shkrim ti drejtohen ne hapësirat ku është i shpalosur pjesa grafike dhe tekstuale e planit, apo edhe në mënyre zyrtare ne sportelin e drejtorisë se urbanizimit.

Qytetarët që ishin të pranishëm në hapjen e shqyrtimit i falënderuan zyrtarët komunal për hartimin e dokumentit duke thënë se një dokument të tillë do tu shërbej për të mirën e gjithë bizneseve që veprojnë në komunën e Prizrenit. Me këtë dokument ne do të kemi mundësi që të bëjmë biznesin ashtu siç edhe ne kemi nevojë.

Shqyrtimi ka përfunduar në orën 10:45.

Me 03.06.2024, është mbajtur shqyrtimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e shqyrtimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-per-projekt-planin-rregullues-i-hollesishem-parku-i-biznesit/>

Procesmbajtës/e: